



Nr. 617 Prot. datë 06/12/2019

Nr. 143 Prot. datë 06/12/2019

Marrëveshje Bashkëpunimi

ndërmjet

Urdhrit të Psikologut

dhe

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS

Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë, në vijim **Urdhri i Psikologut**, me adresë: Blv Gjergj Fishta, Nd 26, Kati 2, Ap 9, është ent publik jobuxhetor, profesional, i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkët të anëtarëve të Urdhrit dhe rregullon veprimtaritë e marrëdhëniet midis tyre në funksion të publikutbazuar në ligjin 40/2016 “Për Urdhrit e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, përfaqësuar nga Presidentja **Znj. Valbona Treska**

dhe

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS, organizatë jofitimprurëse, me adresë: Rr. E Kavajës, Pallati A, Shkalla 3, Hyrja 27, Tiranë; regjistruar si person juridik me Vendimin nr. 5260, datë 11/02/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; me nr. NIPT-i L61429451E, përfaqësuar nga **Znj. Ana Majko**, në cilësinë e Drejtores Ekzekutive, këtej e tutje e cilësuar si “**NISMA**”

Palët në këtë marrëveshje bashkëpunimi bien dakord për nënshkrimin e saj si më poshtë:

NENI 1 **Objekti**

Objekt i kësaj Marrëveshje është përcaktimi i roleve dhe përgjegjësi të ndërsjellta në zbatimin e ndërhyrjes së emergjencës, si rezultat i goditjeve të tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, ndërhyrje e cila synon ngritjen e hapësirave miqësore për fëmijë, vënien e tyre në funksionim dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse psiko - sociale për familjet e dëmtuara dhe fëmijët e tyre, të strehuar në ambiente të ngritura nga strukturat shtetërore.



Palët do të zbatojnë ndërhyrjet e përbashkëta në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe të udhëhequr nga parimi i “*interesit më të lartë të fëmijës*” si dhe standartet e NISMA për ngritjen e hapësirave miqësore për fëmijët dhe ofrimin e shërbimit psiko - social.

NENI II

Baza ligjore

Referuar Ligjit Nr. 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, Ligj Nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” (i ndryshuar), dhe Konventa e OKB-së mbi të “Drejtat e Fëmijës” datë 20.11.1989

NENI III

Qëllimi

Kjo marrëveshje ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve institucionale midis Urdhrit të Psikologut dhe NISMA në zbatimin e ndërhyrjes së emergjencës me qëllim mbështetjen psiko – sociale të fëmijëve dhe familjeve të dëmtuara nga goditjet e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, në zonat e prekura nga tërmeti në Qarkun Durrës dhe Tiranë apo ku mund të lindë nevoja.

NENI IV

Rolet dhe përgjegjësitë e NISMA

1. **NISMA** garanton mbështetjen teknike, profesionale dhe financiare në adresimin e këtyre çështjeve kryesore:

- *Ngritjen dhe organizimin e hapësirave miqësore për fëmijët*
- *Ofrimin e shërbimit psiko - social*

2 **NISMA merr përsipër këto angazhime:**

3. **NISMA** do të rimbursojë shpenzimet për aktivitetet e listuara më sipër pas marrjes së raporteve të detajuar narrative për aktivitetet dhe evidenca nga përfituesit për marrjen e shërbimit të ofruara në përputhje me procedurat e saj.



4. **NISMA** angazhohet të garantojë parimin e ruajtjes së konfidencialitetit për çdo informacion që lidhet me fëmijët apo me familjet e tyre si dhe çdo informacion tjetër sensitiv.

NENI V

Rolet dhe përgjegjësitë e Urdhrit të Psikologut

Urdhri i Psikologut merr përsipër këto angazhime :

1. Në kuadër të zbatimit të ndërhyrjes së emergjencës:

- 1.1 Të sigurojë angazhimin e vazhdueshëm dhe efikas të psikologëve të angazhuar në ndërhyrjen e emergjencës në ngritjen dhe vënien në funksion të hapësirave miqësore për fëmijët në zonat e prekura nga tërmeti.
- 1.2 Të sigurojë shkëmbimin e informacionit të nevojshëm me NISMA në kuadër të ofrimit të shërbimeve psiko – sociale për fëmijët dhe familjet e dëmtuara si pasojë e goditjeve të tërmetit duke përgatitur raport ditor për aktivitetet e kryera dhe numrin e përfituesve të vlerësuar.
- 1.3 Të sigurojë bashkëpunimin e psikologëve të angazhuar në ndërhyrjen e emergjencës me stafin e NISMA në ofrimin e shërbimeve psiko – sociale;

2. Urdhri i Psikologut do të garantojë pjesëmarrjen e psikologëve të angazhuar në të gjitha aktivitetet e planifikuara në hapësirën miqësore për fëmijë.

3. Urdhri i Psikologut krijon kushtet e nevojshme që NISMA të përmbushë detyrimet siç përshkruhen në nenin IV të kësaj marrëveshjeje, përfshirë edhe caktimin e një personi kontakti.

NENI VI

Zbatimi i Marrëveshjes

Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, për të qenë partnerë në zbatimin e ndërhyrjes së emergjencës dhe të punojnë së bashku për realizimin me sukses të aktiviteteve të parashikuara.

Urdhri i Psikologut dhe NISMA caktojnë nga një person kontakti që do të jenë pjesë e komunikimit mes palëve, koordinimit të veprimeve dhe monitorimit hap pas hapi të zbatimit të ndërhyrjes së emergjencës nëpërmjet organizimit të takimeve periodike informuese dhe vendim-marrëse.



Në raste të caktuara, në marrëveshje mes tyre, Urdhri i Psikologut dhe NISMA, krijojnë grupe të përbashkëta teknike për hartimin e propozimeve konkrete për ofrimin e shërbimeve psiko – sociale për fëmijët dhe familjet e dëmtuara.

NENI VII **Kohëzgjatja**

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj dhe do të jetë e vlefshme deri në 31 dhjetor 2019.

Palët mund të ndryshojnë ose të shtojnë në këtë Marrëveshje. Çdo ndryshim apo shtesë në këtë Marrëveshje bëhet vetëm me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja palët.

NENI VIII **Përfundimi i marrëveshjes**

Secila nga palët mund të përfundojë këtë Marrëveshje në rastet kur:

- a. mbaron afati i kohëzgjatjes i përcaktuar në marrëveshje;
- b. shkelen dispozitat e ligjit dhe të marrëveshjes;
- c. palët nuk i përmbahen qëllimit dhe objektit të marrëveshjes;
- d. për forcë madhore

Secila nga palët duhet të njoftojë palën tjetër me shkrim, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të marrëdhënieve të Marrëveshjes, duke dhënë sqarime të hollësishme dhe të qëndrueshme mbi këtë ndërprerje.

Për çdo rast, pavarësisht mënyrës së përfundimit, secila nga palët do të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja, deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve.

NENI IX **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me mirëkuptim, me bisedime ndërmjet tyre, deri në gjetjen e një zgjidhje të përbashkët.

NENI X **Dispozita të fundit**



Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara deri në fund të marrëdhënieve të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, për të qenë partnere në zbatimin e saj, duke punuar së bashku për realizimin e veprimtarive.

Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.

NENI XI **Hyrja në fuqi**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët. Hartohet në 2 kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga një kopje për secilën palë.

Për Urdhrin e Psikologut

Znj. Valbona Treska
Presidente

Për Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS

Znj. Ana Majko
Drejtore Ekzekutive